



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0278
Data e Vendimit: 12.05.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “WealthWave L.L.C” kundër vendimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA – Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve-Lot I-II” me numër të prokurimit:616-26-1322-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës, Kryesuesi i Sekretariatit Ardian Behra, me datën: 12. 05. 2026, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtëafatshme, ankesa e OE “WealthWave L.L.C” me nr. të protokollit 2026/0278, e datës 30.04.2026, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA – Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve-Lot I-II” me numër të prokurimit: 616-26-1322-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA – Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve-Lot I-II” me numër të prokurimit: 616-26-1322-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar pagesë të tarifës më rastin e parashtrim të ankesës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 30.04.2026, ka pranuar ankesën lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA – Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve-Lot I-II” me numër të prokurimit: 616-26-1322-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, në cilësinë e

Autoritetit Kontraktues. Me 17.03.2026, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë.

Me datën 14.04.2026 (15:09), Operatori Ekonomik “WealthWave L.L.C” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK me datën 17.04.2026 (15:34) ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar.

Me datën 30.04.2026 (10:41), Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokoll 0278/2026.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantura vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit të cituar si në pikën I të dispozitivit, pas pranimit të ankesës, shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, OSHP sqaron se Ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP jashtë afatit ligjor. Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 14.04.2026, ndërkaq AK me datën 17.04.2026 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar. Ankesa në OSHP është parashtruar me datën 30.04.2026 i bie që është e jashtëafatshme sepse është parashtruar jashtë afatit 10 ditor për parashtrim të ankesës.

Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Sipas kësaj dispozite ligjore kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Andaj nga kalkulimi i ditëve del se ankesa e parashtruar në OSHP është e jashtëafatshme, sepse kanë kaluar dhjetë (10) ditë për parashtrim të ankesës ashtu siç është rregulluar me nenin 109 të LPP-së si dhe nenin 64 paragrafi 1 i Rregullores për Prokurimin Publik ku thuhet: 64.1 *“Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së”*.

Poashtu, ankuesi për këtë ankesë nuk ka paguar tarifë ashtu siç është paraparë me nenin 111 paragrafi 1. 10 të Ligjit për Prokurim Publik ku thuhet se çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP nëse ankesa e tillë ka dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.

Sipas nenit 118 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së thuhet: “1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare. 2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet”.

Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA – Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve-Lot I-II” me numër të prokurimit: 616-26-1322-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - WealthWave L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: